



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:182803

Datë: 13.12.2023

Numri i dokumentit: 05060372

PPP.nr.4A/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh.A. “ K. “ , nga Prishtina, ndaj debitores A. Th. nga Fushë Kosova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.522/23, të datës 11.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat F. C. nga Gllogoci, jashtë seancës, me datë 13.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitores A. Th. nga Fushë Kosova, ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.522/23, i datës 11.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat F. C. nga Gllogoci dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar, ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitores, të cilën e ka detyruar që kreditorit t’ia paguajë shumën e borxhit prej 555.07 euro, në emër të borxhit për konsumimin e energjisë elektrike të krijuar nga data 24.02.2023, deri me datë 09.06.2023, me kamatë prej 8%, si dhe të paguajë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e ka përmbushur obligimin e cekur në propozim për përmbartim para datës së pranimit të urdhrit përmbartimor, dhe kjo vërtetohet me dëshminë e transaksioneve të konsumatorit, të datës 01.08.2023, të cilën ia ka bashkëngjitur prapësimin.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se kërkesa për prapësim e debitorit nuk është në përputhje me nenin 69, parag. 4 të LPP-së, dhe se debitori kërkesën për prapësim e ka bërë vetëm për arsye të zvarritjes dhe prolongimit të procedurës përmbarimore. Përgjigjes në prapësim ia ka bashkëngjitur transaksionet e konsumatorit, të datës 23.08.2023, në dy faqe.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (LPP) gjeti se prapësimi është në tërësi i bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat në shumë prej 555.07 euro është përmbushur në tërësi nga debitori. Ky fakt vërtetohet nga dëshmia e transaksioneve të konsumatorit, të datës 01.08.2023, ku shihet se për periudhën e kërkuar me propozim, pra nga data 24.02.2023 deri më 09.06.2023, debitori ka shpenzuar energji elektrike në shumë prej 535,35 euro (në periudha dhe shuma të ndryshme, si 261.68 euro, 175.19 euro, 7.69 euro, 63.26 euro, 27.53 euro), ndërsa për këtë periudhë, përkatësisht nga data 24.04.2023, e deri më 07.07.2023 ka paguar energjinë elektrike në shumë prej 540 euro (në periudha dhe shuma të ndryshme, si 50 euro, 200 euro, 100 euro, 190 euro), ku pagesa e fundit prej 190 euro është realizuar me datë 07.07.2023, pra para datës së lëshimit të urdhrit përmbarimor.

Ndërsa, nga provat e bashkëngjitura në përgjigje në prapësim nga kreditori, shihet se debitorja e ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit, dhe borxhi aktual i saj është -2.12.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, u vendos si në dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që Ekstrakti i verifikuar, i lëshuar nga kreditori, i datës 06.07.2023, në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarimor, tanimë e ka humbur efektin juridik.

Ndërsa, vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarimore, gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-së, i cili përcakton se *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.4A/2023, dt.13.12.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes se të njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.